



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

NR 07 ,Dt. 15.03.2024

**MBI DHËNIEN NË HUAPËRDORJE NË FAVOR TË INSTITUCIONIT TË  
PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË, KATIN E PARË TË GODINËS E CILA ËSHTË NË  
PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 77 gërma (e), me propozim të Kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë.

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënie në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, të katit të parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë me të dhënat, Pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m<sup>2</sup> ndodhur në Lagjja.7, Rruga "28 Nëntori" nr.1, Korçë
2. Periudha për të cilën kati i parë i godinës i specifikuar në pikën 1 të Vendimit, do të lihet në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë do të jetë 3 vjet nga përfundimi i afatit të kontratës aktuale (17.07.2024 -17.07.2027).
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Specialisti i nivelit të lartë për shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat civile dhe Kabineti i Kryetarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ERJON NEXHTI

Koncept. : R. Latollari  
Kësh. Juridik : Gj.Kristo  
Sekretar i K.Qarkut: B.Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### **“MBI DHËNIEN NË HUAPËRDORJE NË FAVOR TË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË, KATIN E PARË TË GODINËS E CILA ËSHTË NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË”**

Pas shkëmbimit të ndërtesave respektive midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë bazuar në VKM Nr. 601 datë 31.08.2016, për rregullimin e situatës së krijuar faktike dhe ligjore nga ky shkëmbim, Këshilli i Qarkut Korçë me mirëkuptim ka rishikuar mundësinë për tu siguruar ambiente për ushtrimin e funksioneve të tyre edhe institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucioneve të tjera. Në kushtet aktuale Këshilli i Qarkut Korçë i ka dhënë në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë me një afat 5-vjeçar, katin e parë të godinës ku aktualisht institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë ushtron veprimtarinë.

Pranë Këshillit të Qarkut Korçë është administruar shkresa e Drejtorisë të buxhetit dhe menaxhimit financiar të Ministrisë të Brendshme me Nr. 171/1 Prot. datë 19.01.2024 dhe objekt kërkesë: “Mbi transferimin e disa pasurive nga Këshilli i Qarkut te Prefekti i Qarkut Korçë”. Objekt i shkresës së paraqitur është kërkesa për kalimin në pronësi të Ministrisë të Brendshme të ambienteve në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, konkretisht katin e parë të godinës, pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m<sup>2</sup>, dhe katin përdhe të godinës, pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m<sup>2</sup>.

Aktualisht Këshilli i Qarkut Korçë zotëron vetëm këtë pasuri e cila rezulton e ndarë në dy Çertifikata pronësie, regjistruar në zbatim të VKM-së Nr. 601 datë 31.08.2016 “Për kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, dhe kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1223, datë 3.9.2008, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë”.

Me kontratë huapërdorje Nr. 644 Prot. datë 17/07/2019 institucionit të Prefektit të Qarkut i është dhënë në përdorim kati i parë i godinës, pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m<sup>2</sup> ndodhur në Lgj.7, Rruga “28 Nëntori” nr.1, Korçë.

Kati përdhe i godinës, pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m<sup>2</sup> është vendosur në dispozicion të institucioneve të tjera të sistemuara, si Zyra e Përmbaramit Shtetëror Korçë, Zyra e Statistikës Korçë dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, por për efekt

përdorimi të ambienteve të përbashkëta dhe katit nën tokë, kushtëzuar edhe nga një pikë lidhjeje e energjisë elektrike dhe ujit, kontrata është nënshkruar me Institucionin e Prefektit të Qarkut.

Në kushtet kur vetë Këshilli i Qarkut ushtron veprimtarinë në ambientet e ndërtesës që nuk është në pronësi të tij (Kontratë Huapërdorje me Bashkinë Korçë) dhe statusi i ndërtesës në tërësi nuk është i qartë nga ana juridike por edhe funksionale në raport me ambientet e përbashkëta, katin nën tokë, truallin nën ndërtesë dhe pjesët funksionale të tij, deri në zgjidhjen përfundimtare të situatës së krijuar, nisur nga vullneti i bashkëpunimit ndërinstytucional por edhe për të garantuar mirëfunksionimin e institucionit të Prefektit, propozohet dhënia në huapërdorje e katit të parë të godinës, pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m<sup>2</sup> edhe për 3 vite të tjera nga data 17.07.2024 deri në datën 17.07.2027.

Koncept. : R. Latollari

Kësh. Juridik : Gj.Kristo

